



Permbledhje joteknike e aktiviteteve

Menaxhimi i mbetjeve, I.D 5.9 Magazinim i përkohshëm i mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontejnerët ose nga larjet e kontejnerëve, dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë magazinuar për jo më shumë se 7 ditë.

Menaxhimi i mbetjeve, I.D 5.10 a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart.



Subjekti: “Pastrimi Detar” Sh.a.

Hartoi: “EKO- STUDIO- PROJEKT” sh.p.k

Administrator: Erina M. DANI



Tirane, 2024



PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje**
- ✚ Baza ligjore**
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit**
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se**

- 1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
- 2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
- 3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
- 4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
- 5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre tepashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qeeshtebere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit ”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”.*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisore te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Udhezim per dokumentacionin e duhur per “Leje Mjedisore”*
- *Urdhëri Nr. 321 datë 11.2.2014 “Për Lejet Mjedisore”*
- *Udhëzim i MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së’*
- *VKM nr. 686 datë 29.7.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afatave për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.*
- *Ligji 12.2015 date 26.02.2015 ”Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440 datë 7.7.2011”Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”.*



1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Subjekti "Pastrimi Detar" sh.a., me administrator *Z. Ilir Karagozi*, i regjistruar ne me numer NIPT-i **J61805509H**, zhvillon aktivitetin "Magazininim i përkohshëm i mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontejnerët ose nga larjet e kontejnerëve, dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë magazinuar për jo më shumë se 7 ditë.", aktivitet i cili do të ushtrohet ne Fshati Shkallnur, ZK Nr. 3385, Nr. Pasurie 585, Durres.

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti kapaciteti magazinues eshte **2000 m³**.



	GK	
	X	Y
1.	4376504.37	4571746.58



Procesi Teknologjik

Subjekti "Pastrimi Detar" sh.a. ka ne dispozicion makina teknologjike qe sherbejne per grumbullimin e mbeturinave te ngurta si dhe depozita jashte portit ne te cilat depozitohen mbeturina te lengeta ku behet seperimi me impiantin depurator per pastrimin e ujrave te sentinave sipas normave te BE.

Eshte e rendesishme te theksojme se veprimtai te tilla si larja e anijeve, cistern te nenprodukteve te naftes, grumbullimi i vajrave te perdorura si dhe grumbullimi i ujrave te zeza eshte bere per here te pare ne Shqiperi, duke mos lejuar anijet ta derdhnin ate ne dete te hapur.

Investimet e bera rregulluan mangesite e verejtura para vitit 1991 , duke e bere sherbirnin ne nivel te porteve te Mesdheut.

Mos pastrimi ditor i anijeve mund te sjelle kontaminimin e te gjithë gjirit. Impaktet negative te ndotjes se detit nga anijet ne rast te fatkeqesive detare (mbytje anijesh te cilat kane mbeturina e lengeta dhe te ngurta) mund te sjellin shume probleme te cilat duhet te kene kohen e duhur per tu kaluar.

Ato do te ndikonin negativisht konkretisht ne:

1. Prishjen e ekuilibrave ekologjik detar
2. Ndotjen e zonave te peshkimit
3. Ndotjen e zones turistike
4. Prishjen e flores dhe faunes e nen detit

Shoqeria "Pastrimi detar" sh.a. eshte pajisur me te gjithë dokumentacionin perkates per perpunimi, transportimin dhe tregtimin e naftes, te gazit dhe nenprodukteve te tyre. Te gjitha proceset kryhen me nje staf dhe punonjes te trajnuar ku per te gjitha keto sherbime kan veshjet perkatese.

Pasi kryhet mbledhja e mbetjeve te hidrokarbureve, vajra ne siperfaqen e akuariumit te portit nepermjet makinerite teknologjike, do te kryhet transportimi i makinerive autobot drejte vendndodhjes se depozitave ku do te kryhet magazinimi i ketyre mbetjeve.

Zona e depozitimit te ketyre mbetjeve, perbehet nga 10 depozita ne siperfaqe, ku secila prej tyre ka kapacitet magazinues 200 m³. Keto rezervuare formojne kapacitetin total prej 2000 m³.

Rezervuaret jane te pajisura me te gjitha kushtet e nevojshme per te mos patur ne asnje moment rrjedhje te ketyre mbetjeve. Ne keto depozita do te kryhet vetem depozitimi per nje afat te shkurter kohor te ketyre mbetjeve ku me pas do te dergohen per ne impiantin e



trajtimit të po të subjektit "Pastrimi Detar" sh.a. sipas Lejes Mjedisore aktuale që operatori disponon.

Nuk do të ketë ndertime të reja apo nderhyrje në strukturën e depozitave pasi depozitat janë të ndertuara dhe në gjendje të mirë funksioni të cilat do të përdoren nga subjekti sipas kontratës së qerases për përdorimin e depozitave me Nr. Rep. 2677 dhe Nr. Kol. 1380, e lidhur datë 26.09.2024 midis subjektit "Pastrimi Detar" sh.a. dhe subjektit "Petrolimpex" sh.a. për një afat 2 vjeçarë me të drejtë rinovimi.

Lendet e para

Mbetjet me perberje hidrokarbure e terhequr në akuariumin e portit.

Kapaciteti magazinues i depozitimit është 2000 m³.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Pozita Gjeografike



Durrësi është qyteti i dytë më i populluar i Republikës së Shqipërisë dhe selia e Qarkut Durrës dhe Bashkisë Durrës. Ndodhet në një fushë të rrafshët përgjatë bregut shqiptar të detit Adriatik midis grykëderdhjeve të Erzenit dhe Ishëm në cepin juglindor të detit Adriatik. Klima e Durrësit ndikohet thellësisht nga klima sezonale mesdhetare.

Klima

Sipas klasifikimit të klimës Köppen, Durrësi klasifikohet nën periferinë e zonës së nxehtë klimatike mesdhetare të verës (Csa) me një temperaturë mesatare vjetore prej 15,9 °C (60,6 °F). Klima e saj ndikohet nga afërsia me detin Adriatik në Detin Mesdhe dhe kodrat në Ultësirën Perëndimore në brendësi. Vera është kryesisht e nxehtë dhe e thatë, dimri relativisht i butë, dhe vjeshta dhe pranvera kryesisht të qëndrueshme, për sa i përket reshjeve dhe temperaturave. Temperatura mesatare mujore varion nga 7,5 °C (45,5 °F) në dimër deri në 23,8 °C (74,8 °F) në verë. Temperatura më e lartë prej 39 °C (102 °F) u regjistrua më 14 gusht 1957. Temperatura më e ulët prej -6.2 °C (20.8 °F) u regjistrua më 26 janar 1954. Durrësi merr pjesën më të madhe të reshjeve në muajt e dimrit dhe më pak në muajt e verës. Reshjet mesatare vjetore variojnë midis 1,000 milimetra (39 in) dhe 1,273 milimetra (50,1 in).

Durrës - Temperatura dhe reshjet mesatare mujore

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrikk	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Temp. Maks. (°C)	11	12	15	18	23	28	30	30	26	22	17	12	∅ 20,3
Temp. Mini. (°C)	4	5	8	11	15	19	21	21	17	14	10	6	∅ 12,6
Reshje (mm)	91	103	99	83	63	50	31	43	118	80	146	140	Σ 1.047





Relievi

Territori i qytetit të Durrësit bën pjesë në ultësirën Adriatike (ultësira perëndimore). Relievi ka moshe të re sepse është formuar shumë vone. Rol të rëndësishëm në formimin e relievit kanë pasur dhe kanë: klima mesdhetare, veprimtaria e ujrave rrjedhës, agjentet atmosferike dhe vete njeriu. Relievi i Durrësit ka keto tipare:

1. Ka karakter fushor.
2. Relievi është gershetimi i formave të rrafshta me ato kodrinore.
3. Relievi është eroziv, që do të thotë grryhet.
4. Një pjesë e mirë e relievit të Durrësit është relievi bregdetar. Në relievin bregdetar ndërthuren kepe dhe gjire. Të tilla janë: kepi i Bisht Palles, kepi i Rodonit kepi i Lagjit, gjiri i Durrësit, gjiri i Lalzit, gjiri i Rodonit etj.

Në qytetin e Durrësit dallohen disa tipe relievesh: bregdetar, fushor, kodrinor, lumor, kodrinor.

- Relievi i Durrësit shtrihet si rrip i ngushtë përgjatë vijës bregdetare, që dallohet për alternimin e plazheve ranore me kepe shkembore.
- Relievi lumor përbehet nga: luginat e lumenjve Erzen dhe Ishem. Format më të përhapura të lumenjve janë luginat lumore.
- Relievi i ulet përfaqësohet nga fushat: e Durrësit, Shijakut e Spitalles.
- Keneta e Durrësit ndodhet në ultësirën bregdetare perëndimore të Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe prej 3600 ha.





Ekonomia

Durrësi është një lidhje e rëndësishme me Evropën Perëndimore për shkak të portit të tij dhe afërsisë me qytetet portuale italiane, veçanërisht Barin, në të cilin udhëtojnë tragetet çdo ditë. Përveç kantierit detar, ai posedon gjithashtu një kantier detar dhe industri të rëndësishme prodhuese, veçanërisht prodhimin e produkteve të lëkurës, plastikës dhe duhanit.

Shtirja bregdetare jugore e Golemit është e njohur për turizmin e saj tradicional masiv të plazhit që ka përjetuar zhvillim të pakontrolluar urban. Plazhet e qytetit janë gjithashtu një destinacion popullor për shumë turistë të huaj dhe vendas. Në vitin 2012, sistemet e reja të kanalizimeve të ujit po instalohen për të eliminuar ndotjen e ujit të detit. Në të kundërt, pjesa veriore bregdetare e Gjirit të Lalzit është kryesisht e paprishur dhe e vendosur të bëhet një destinacion elitare turistik, pasi një sërë resorte plazhi po ndërtohen që nga viti 2009. Rrethet fqinje janë të njohura për prodhimin e verës së mirë dhe një shumëllojshmëri produktesh ushqimore.

Sipas Bankës Botërore, Durrësi ka bërë hapa të rëndësishëm për fillimin e një biznesi në vitin 2016. Durrësi renditet i nënta ndër 22 qytete në Evropën Juglindore përpara kryeqytetit Tiranë, Beograd, Serbi dhe Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë.

Pershkrim i ujrave sipërfaqesore dhe nentokesore

Ujrat sipërfaqesore

Zona është e varfer në burime ujore sipërfaqesore natyrore por pershkohet nga një rrjet i dendur kanalesh kulluese, prania e të cilave i dedikohet kryesisht punimeve të kryera për bonifikimin e ish kenetes së Durrësit. Rreth 6.5 km vllje ajrore në veri është grykederdhja e Erzenit, i cili rrjedh në lindje dhe veri të zones, me një rreze përfaqësisht 7 km. Rreth 2 km në perëndim të saj shtrihet vija bregdetare e Adriatikut.

Ujrat nentokesore

Ujra nentokesore të shkëmbinjve të shkrifet ose kompleksi i depozitimeve Kuartenare, të cilat takohen në shtresat me pershkrueshmeri të vogël deri të mjaftueshme, të tipit lagunor-kenetor, të formuar në fushen e ish Durrësit. Shtresa kolektore ujembajtëse e rërave të imta që takohet në fushen e Durrësit ka pershkrueshmeri të dobët dhe veti kolektore të vogla. Karakteri lokal dhe i kufizuar i vecorive ujembajtëse të këtyre shtresave shpjegohet me faktin se ato shtrihen në formë "Oreole" mbi ujrat e kripura detare, të cilat kanë desitet më të mëdha se ujrat e embla. Duke u ndodhur në kushte të tilla, shfrytëzimi i këtyre ujërave pa kriter dhe sasi më të mëdha se ato të rekomanduara, sjell menjëherë, prishjen e ekuilibrit hidrogeologjik ekzistues me pasoje depertimin e ujërave të kripur detare dhe prishjen e cilesise së tyre, duke i bërë ato praktikisht të pashfrytëzueshme.



3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për të zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer.

Shkarkime në ujë

Gjatë zhvillimit të aktivitetit nuk do të kemi përdorim të ujit në procesin teknologjik dhe si rrjedhojë nuk do të kemi shkarkime në ujë sipërfaqësore apo kanalizime.

Emetimet në ajër

Gjatë fazës së funksionimit të këtij aktiviteti do të kemi emetime të lehta në ajër në mjediset e jashtme. Ky emetim do të vijë si pasojë e klirimit të gazeve dhe të grimcave të pluhurit nga levizja e automjeteve të cilat do të kryejnë transportin e lëndës që magazinohet.

Zhurmat dhe vibrimet

Në mjediset e jashtme zhurmat dhe vibrimet do të jenë prezent vetëm gjatë levizjes së automjeteve të transportit të lëndës që magazinohet..

Mbetjet e prodhuara

Mbetjet të cilat do të prodhohen nga ana e subjektit janë vetëm ato urbane të cilat krijohen nga stafi i cili do të punojë. Këto mbetje do të grumbullohen në kosha të vecante dhe me pas do të depozitohen në vendgrumbullimin e përcaktuar nga Nj.Q.V (koshat).

Thëksojmë se nuk do të ketë mbetje nga depozitat duke qenë se depozitat janë të ndërtuara për këto objektive pra që të mos kenë rrjedhje.

Ndikime në biodiversitet

Gjatë fazës së funksionimit të këtij aktiviteti nuk do të kemi ndikime në biodiversitet. Flora dhe fauna e zonës nuk do të ndikohet nga aktiviteti i shoqërisë.

4. MASAT PËR ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Masat për shkarkimet në ujë

Gjatë zhvillimit të aktivitetit nuk do të kemi përdorim të ujit në procesin teknologjik dhe si rrjedhojë nuk do të kemi shkarkime në ujë sipërfaqësore apo kanalizime.



Masat per emetimet ne ajer

Gjate fazes se funksionimit te ketij aktiviteti do te kemi emetime te lehta ne ajer ne mjediset e jashtme. Ky emetim do te vije si pasoj e clirimit te gazeve dhe te grimcave te pluhurit nga levizja e automejteve te cilat do te kryejen transportin e lendes qe magazinohet.

Subjekti do te kujdeset qe te gjitha automjetet qe bejne te mundur transportin e lendes qe magazinohet te jene te kolauduara dhe ne gjende te mire pune. Gjithashtu per uljen e perqendrimit te grimcave te pluhurit, subjekti ne periudhe te thate do te realizoje sperkatjen e ambjenteve te jashtme me uje.

Zhurmat dhe vibrimet

Ne mjediset e jashtme zhurmat dhe vibrimet do te jene prezent vetem gjate levizjes se automjeteve te transportit te lendes qe magazinohet.

Per te ulur prezencen e zhurmave dhe vibrimeve ne mejdiset e jashtme, do te tregohet nje kujdes i vecant qe gjate transportit te lendes qe magazinohet levizja e automjeteve te jete me shpejtesi te ulet si dhe te jene te kolauduara dhe ne gjende te mire pune.

Mbetjet e prodhuara

Mbetjet te cilat do te prodhohen nga ana e subjektit jane vetem ato urbane te cilat krijohen nga stafi i cili do te punoj. Keto mbetje do te grumbullohen ne kosha te vecante dhe me pas do te depozitohen ne vendgrumbullimin e percaktuar nga Nj.Q.V (koshat).

Theksojme se nuk do te kete mbetje nga karburantet duke qene se depozitat jane te kontrolluara dhe nuk do te kene rrjedhje.

Masa te pergjithshme

- Trajnim te punonjesve dhe masa te pergjithshme te mbrojtjes se mjedisit.
- Kontroll I shpeshte I depozitave qe mbajne lenden, per rrjedhejen apo demtimin e tyre
- Te sigurohet qe rrjeti elektrik te mos kete kontakt me mjedisin e punes
- Sigurimi I mbrotjes nga zjarri, pajisja me mjetet perkatese, fikse zjarri, uje etj
- Sigurimi qe mbetjet te trajtohen sipas planit te parashikuar.
- Sistemimi I materialeve ne vendet e caktuara.
- Te merren masa dhe te kryhet rehabilitimi i mjedisit ne rastet e ndonje aksidenti.
- Te kryhet rregullisht kontrolli gjendjes teknike te teknologjise dhe mjeteve te transportit
- Te kryhet rregullisht kontrolli gjendjes teknike te teknologjise qe perdoret per proceset e aktivitetit.
- Te kontrollohen, pastrohen dhe mirembahen kanalet /gropat kulluse ku behet shkarkimi i mbetjeve te lengeta dhe uji.
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik, si dhe me efektet pluhurave, zhurmave, vibrimet etj në jetën e tyre të përditëshme si dhe të merren masat e duhura për monitorimin në vazhdimësi të tyre me aparataturat dhe instrumentet e nevojshme.



- Evadimi i mbetjeve te gjeneruara nga aktiviteti i punonjesve ashtu sic e parashikon legjislacioni aktual ne fuqi.
- Kontrolli periodik i konteniereve te depozitimit te mbetjeve urbane.

Masat per mbrojtjen kunder zjarrit

Masat per mbrojtjen kunder zjarrit jane shume te rendesishme. Ato jane parashikuar ne projekt dhe jane si me poshte:

- Largimin e materialeve te ndezshme nga ambientet e godines dhe vendosjen e tyre ne vende te sigurta per parandalimin e transmetimit te zjarrit
- Mbjajtje e lire e rrugeve te largimit
- Mirembajtje dhe kontroll i vazhdueshem i instalimeve elektrike ne perputhje me rregullat perkatese per instalime te tilla.
- Pozicionimi i shenjave ne vende te dukshme dhe vendosja e instruksioneve per veprimet qe duhet te kryeje personeli ne rast zjarri.
- Pozicionimi i shenjave qe paraqesin pozicionet e shuaresve te zjarrit, rruget e largimit dhe daljet e emergjnces.
- Duke marre ne konsiderate karakteristikat e nderteses si dhe destinacionin e saj jane perdorur substanca shuaresive si me poshte:
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidratante te jashtem
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidtrante te brendshem
 - Shuares portable ne te gjitha pozicionet te cilat parashikohen ne projekt.

Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune

➤ Detyrat e subjektit qe do te zhvilloje aktivitetin:

- Jane punesuar punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialist te profesioneve qe kerkohen.
- Jane punesuar punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.
- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.
- Punonjesit pajisen me mjete mbrojtese si dhe uniformat perkatese,
- Do te instruktohen punonjesit ne menyre periodike.

➤ Detyrat e punonjesve:

- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.
- Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjeve ne perdorim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt te tyre fillon punen.
- Kur konstaton difekt dhe nuk eshte ne gjendje ta eliminoje ndalon punen dhe ve ne dijeni pergjegjesin me te afert.
- Te perdore mjetet individuale te mbrojtjes gjate punes.



5. Konkluzione dhe Rekomandime

Konkluzione

- Zbatohen rregullat e sigurimit teknik në punë. Punohet për krijimin e kushteve optimale të punës per punonjesit .
- Depozitat qe mbajne lenden qe do te magazinohet te jane te pajisura me flakepenguese.
- Subjekti kujdeset per menaxhimin e mbetjeve te krijuara nga veprimtaria e personelit te punes, duke i transportuar ne menyte te rregullt ne vend grumbullimet e caktuara nga pushteti vendor.

Rekomandime

- Te kontrollohen kushtet teknike te mjeteve te punes ne menyre periodike per te evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve ne mjedis, emetimin e gazeve dhe zhurmave te teperta te shkaktuara nga avari teknike te mjeteve.
- Sherbimi i automjeteve, ruajtjes se lubrifikanteve dhe pjeseve te automjeteve te behen ne vend ete tilla qe te evitojne ndotjen ne mjedis.
- Punonjesit te njihen ne mneyre periodike me kushtet e Lejes Mjedisore dhe pasojat e moszbatimit te tyre ne mjedis.